

PROCESVERBAL
nga seanca e 37-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 30.09.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm edhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski hapi seancën e 37-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:10 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Jançeski shpjegoi se për arsye teknike në seancë do të përfshihet nëpërmjet lidhjes audio, gjegjësisht pa mundësinë e transmetimit video.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi rendin e ditës:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 36-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 19.09.2024.
2. Propozim-vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel lokal, në zonën e komunës së Negotinës, me Propozim-dokumentacion konkursi dhe Propozim-aplikim.
3. Propozim-vendim për ndryshim të strukturës së pronësisë të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë.
4. Propozim-aktvendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION KANAL 8 SHPKNJP Koçan.

5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit A1 Maqedoni nga Shkupi për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
6. Informacion në lidhje me vendimin e Qeverisë së RMV-së për ndërprerjen dhe dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës së paluajtshme Ministrisë së Sportit, me Propozim-Vendim dhe Propozim-Marrëveshje.
7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbime hidraulike dhe elektrike.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 36-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 19.09.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel lokal, në zonën e komunës së Negotinës, me Propozim-dokumentacion konkursi dhe Propozim-aplikim. Ai ka shpjeguar se në adresën zyrtare të postës elektronike të Agjencisë më datë 18.06.2024, nga pala e interesuar person fizik nga Negotinë, është dorëzuar Kërkesë për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal, në zonën e qytetit të Negotinës. Në bazë të ligjit, Agjencia ka përgatitur Studim për përcaktimin e arsytimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio jofitimprurëse në nivel lokal, në zonën e komunës së Negotinës, i cili është publikuar në ueb faqen e Agjencisë. Gjetjet e Studimit treguan se ka arsytim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio jofitimprurëse dhe se: grupi i synuar i transmetuesit duhet të jetë popullata lokale e komunës së Negotinës; gjuha në të cilën do të transmetohet pjesa e folur e shërbimit programor të jetë në gjuhën maqedonase; së paku 10% e totalit të programit të transmetuar gjatë javës duhet të jetë përmbajtje me fjalë; së paku 70% e përmbajtjes së folur duhet të jetë përmbajtje që kanë rëndësi specifike dhe relevante ose interes për popullatën e zonës lokale - informacione të rëndësishme shërbimi, informacione për ngjarjet në zonë, përmbajtje që do të trajtojnë tema lokale nga fusha e kulturës, sportit, ekonomisë, ekologjisë e të tjera, dhe do të mundësojë përfshirjen dhe debatin e qytetarëve. Duke pasur parasysh se sipas Planit për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave është përcaktuar se ekziston radio frekuencë e lirë për qytetin e Negotinës, dhe sipas konkluzioneve të Studimit, sugjerohet që Këshilli ta pranojë propozimin.

Z. Fidanoski tha se sinqerisht gëzohet kur merren vendime të tilla, sepse me to zgjerohet peizazhi mediatik dhe pasurohet pluralizmi. Ai beson se shumë shpejt do të vijojë një konkurs publik i realizuar me sukses, pas të cilit do të merret një medium i ri transmetues lokal në territorin e komunës së Negotinës. Ai deklaroi se do ta mbështesë propozimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv

Jofitimprurës, në nivel lokal, në zonën e komunës së Negotinës, dedikuar për popullatën lokale të zonës së Komunës së Negotinës, në gjuhën maqedonase, e cila do të transmetohet përmes radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikim Elektronik të RMV-së, përkatësisht: 91.7 MHz, me dokumentacion Konkursi dhe Aplikim për pjesëmarrje në konkursin publik.

Së paku 10% e totalit të programit të transmetuar gjatë javës duhet të jetë përmbajtje e folur, dhe së paku 70% e përmbajtjes së folur duhet të jetë përmbajtje që është me rëndësi specifike dhe relevante ose me interes për popullatën e zonës lokale – informacione të rëndësishme shërbimi, informacione për ngjarjet në zonë, përmbajtje që do të trajtojnë tema lokale në fushën e kulturës, sportit, ekonomisë, ekologjisë etj., si dhe do të mundësojë përfshirjen dhe debatin e qytetarëve.

Sektori për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta boton në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuale, si dhe së paku 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe hyn në fuqi nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva shpjegoi Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë. Ajo ka shpjeguar se Njoftimi i dorëzuar për ndryshim të strukturës së pronësisë të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë është i plotë dhe i rregullt, përkatësisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë. Agjencia, me qëllim që të hetojë nëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë do të krijojnë përqendrim të paligjshëm mediatik, përmes sistemit shpërndarës të internetit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka kryer një kontroll dhe në Regjistrin e Pronarëve të Paluajtshëm të mbajtur nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është konstatuar se me zbatimin e ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë nuk krijohet koncentrim i paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht se ky ndryshim nuk në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë.

Z. Ajdini i dëshiroi sukses në punë pronarit të ri të këtij televizioni dhe shpreson që problemet financiare që kishte transmetuesi do të tejkalohen dhe në të ardhmen do të vazhdojë të punojë me sukses dhe profesionalizëm duke respektuar dispozitat ligjore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim me të cilin lejohet ndryshim në strukturën e pronësisë të SHTR TV GURRA SHPKNJP nga Kërçova, me tekstin e propozuar në vendim.

Me ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të SHTR TV GURRA SHPKNJP nga Kërçova nuk krijohet koncentrim i paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-aktvendimin për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION KANAL 8 SHPKNJP Koçan. Ai shpjegoi se sipas Ligjit bëhet fjalë për fazën e fundit pas heqjes ose kthimit të lejes, gjegjësisht sipas nenit 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 Leja për transmetim televiziv ose radio pushon së vlefshmi në bazë të Ligjit, sipas deklaratës me shkrim të zotëruesit që njofton Agjencinë se ndërpreu transmetimin e programit televiziv dhe radio. Meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore, sugjerohet që Këshilli të pranojë propozimin.

Z. Fidanoski tha se po aq sa është i lumtur për mundësinë e hapjes së mediumit të ri në nivel lokal, si në një nga pikat e mësipërme, aq është i shqetësuar nga momenti kur Këshilli duhet të vendosë për mbylljen dhe fshirjen nga regjistri i një mediumi ekzistues. Ai tha se në seancën publike e ka dëgjuar me vëmendje diskutimin e z. Ajtovski, me të cilin janë kolegë me profesion si (gazetarë) dhe tha se plotësisht i kupton argumentet e tij që i paraqiti ndaj gjendjes ekonomike që u detyruan në një hap të tillë. Atij i vjen keq duke perifrastuar një revolucionar maqedonas - "Më mirë një fund i tmerrshëm se sa tmerr i pafund", domethënë, siç tha në këtë situatë, është e qartë se nuk ka pasur mundësi të vazhdohet me funksionimin e mëtejshëm. Sa i përket Rregullores së re për kushtet minimale kadrovike, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ai tha se edhe atëherë kanë paralajmëruar se me këtë hapen dyert për mbylljen e disa mediave më të vogla lokale dhe rajonale, gjë që tashmë ka filluar të ndodhë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION KANAL 8 SHPKNJP Koçan.

Sektori për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta boton në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 5

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit A1 Maqedoni nga Shkupi për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV. Ai shpjegoi se data e kryerjes së mbikëqyrjes është 25 shtator të këtij viti, nga ku është konstatuar se ka ritransmetuar mbi 40 shërbime programore të cilat nuk mbulohet me çertifikatën për regjistrim të dhënë nga Agjencia, e cila është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Për këtë arsye sugjerohet që t'i shqiptohet masë vërejtje publike.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-3942/1 datë 26.09.2024 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për shërbime të komunikimit A1 MAQEDONI SHPKNJP Shkup t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në përputhje me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastër) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, udhëzohet që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se Shoqëria për shërbime të komunikimit A1 MAQEDONI SHPKNJP Shkup, e cila sipas njoftimit të Agjencisë për komunikime elektronike mund të kryej veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datë 25.09.2024 për shfrytëzuesit e saj ka ritransmetuar shërbimet programore "TV Shenja", "TV Vistel", " Nickelodeon", " Nick Jr ", "Nictoos", " Epic Drama", "TV 1000", " Klasik TV HR", "Timeless Dizzy Channel", "Arena Sport 1", "Arena Sport 2", " Arena Sport 3", " Arena Sport 4", "Arena Sport 5", "Arena Premium 1", "Arena Premium 2", "Arena Premium 3", "Viasat Nature", "Viasat Explorer", "Viasat Histori", "Museum", "Luxe TV", "Ballkan Trip", "RTS Svet", "Agro TV", "Arena Fight", " Al Jazeera", "a tv ", "TRT Turk", "Toxic", "Toxic Folk", "Toxic Rap", "MTV 00", "MTV Europe", "MTV Hits", "MTV Life ", "Nick Music", "MTV 90", "MTV 80", "Club MTV", "Bloomberg" dhe "Duck TV", të cilat nuk mbulohen me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike duhet të hartojë Akvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për operatorin në fjalë.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtën e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Akvendimin për paralajmërim publik të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 6

Z. Trajçevski shpjegoi Informacionin në lidhje me vendimin e Qeverisë së RMV-së për ndërprerjen dhe dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës së paluajtshme Ministrisë së Sportit, me Propozim-Vendim dhe Propozim-Marrëveshje. Ai shpjegoi se Këshilli i Agjencisë, me kërkesë të Ministrisë së Sportit të RMV-së për dhënien në shfrytëzim të hapësirës afariste për një periudhë të kufizuar kohore, mori Vendim ku miratoi që Ministrisë së Sportit t'i japë në shfrytëzim të përkohshëm, për një periudhë të kufizuar prej 5 (pesë) vitesh, pa kompensim, hapësirë me sipërfaqe totale prej 171 M2, në katin e 8-të të pallatit "Panko Brashnarov", të cilën Agjencia ka të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm, dhe pas marrjes së pëlqimit të Qeverisë së RMV-së. Në Vendimin e cituar, është konstatuar se kushtet nën të cilat do të jepet në shfrytëzim të përkohshëm hapësira, do të rregullohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Agjencisë dhe Ministrisë së Sportit të RMV-së, e cila është marrëveshje e kushtëzuar dhe nënshkrimi i saj do të konsiderohet ligjërishit i vlefshëm dhe do të ketë pasoja juridike vetëm pas marrjes së pëlqimit të Qeverisë së RMV-së. Në pikën 2 të Vendimit në fjalë është përcaktuar se Agjencia nuk do të marrë pjesë financiarisht në investimin për rinovimin (përshtatjen) e hapësirës në ambjente për zyra, të cilën në tërësi do të kryhet nga Ministria e Sportit e RMV-së, dhe pas skadimit të afatit për shfrytëzim të përkohshëm, Ministria e Sportit e RMV-së obligohet që t'ia dorëzojë sërish hapësirën në gjendje të mirë për shfrytëzim të përhershëm Agjencisë, ndërsa të gjitha investimet për rinovime (përshtatje) ose lloje të tjera ndryshimesh në hapësirë si investim mbeten në dispozicion pa kompensim Agjencisë. Qeveria e RMV-së në seancën e mbajtur me datë 17.09.2024, miratoi Vendim për ndërprerjen dhe dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme, sipas të cilës Agjencia (si shfrytëzues aktual) pushon së shfrytëzuar

një pjesë të pasurisë së paluajtshme – hapësirë afariste, në Pallatin “Panko Brashnarov”, kati 8. Në Vendim, përcaktohet se dorëzimi i pasurisë së paluajtshme do të kryhet ndërmjet Agjencisë dhe Ministrisë së Sportit të RMV-së, në afat prej tetë ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit. Vendimi ka hyrë në fuqi ditën e nesërme nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të RMV-së, gjegjësisht me datë 20.09.2024. Në pajtim me nenin 18 paragrafi (4) të Ligjit për shfrytëzimin dhe disponimin me mjetet në pronën shtetërore dhe pronën komunale ¹, Qeveria vendos për ndërprerjen e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme në pronësi shtetërore të shfrytëzuar nga autoritetet shtetërore, personat juridikë të themeluar nga shteti, komunat, komunat në qytetin e Shkupit, qytetin e Shkupit, shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet. Kështu, me datë 26.09.2024, Ministria e Sportit e RMV-së e informoi Agjencinë për qëndrimin e Ministrisë se është e nevojshme të lidhet një marrëveshje për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella vetëm me përcaktimin e një raport të ri të shpenzimeve të përbashkëta snë pajtim me kvadraturën (katrorët) që do tëa shfrytëzojë çdo institucion. Si rrjedhojë nga sa më sipër, në vendimin e Këshillit të Agjencisë u vendos të ndryshohet pjesa në pikën 1, në të cilën është konstatuar se miratohet që Agjencia të japë në shfrytëzim të përkohësisht pjesën e pronës në fjalë pas marrjes së pëlqimit të Qeverisë së RSM-së, kështu që u vendos që e njëjta të miratohet në bazë të Vendimit të Qeverisë së RMV-së, kështu që u vendos se e njëjta miratohet në bazë të Vendimit të Qeverisë së RMV-së për ndërprerje dhe dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të hapësirës së paluajtshme Ministrisë së Sportit të RMV-së. Po ashtu pika 2, në të cilën ishte përcaktuar se Agjencia nuk do të marrë pjesë financiarisht në investimin për rinovimin(përshtatjen) e hapësirës, është vendosur që të fshihet, dhe pika 3 - në pjesën në të cilën është përcaktuar se marrëveshja për rregullimin e marrëdhënieve për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirës është i kushtëzuar dhe se i njëjti do të konsiderohet ligjërisht i vlefshëm pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e RMV-së, u vendos që të ndryshohet ashtu në mënyrë që të përcaktohet se Agjencia dhe Ministria e Sportit të RMV-së do të lidhin (nënshkruajnë) marrëveshje për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella dhe bashkëpunimit afarist-teknik. Pjesa tjetër e Vendimit me ark.nr.02-3260/1, datë 24.07.2024 nuk ndryshon.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Agjencisë nr.02-3260/1, datë 24.07.2024 dhe i dha miratim drejtorit të Agjencisë për nënshkrimin e Marrëveshjes për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella dhe bashkëpunimit afarist-teknik, të harmonizuar sipas vërejtjeve të Agjencisë.

Agjencia drejtuar Ministrisë së Sportit të RMV-së të dorëzojë Vendimin dhe kopjet e nënshkruara/të vërtetuara të Marrëveshjes.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: Shërbime hidraulike dhe elektrike. Ajo ka shpjeguar se për fillimin dhe zbatimin e procedurës janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Është e paraparë në Planin Vjetor për furnizime publike të Agjencisë dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për këtë vit. Kontrata do të lidhet për një periudhë 1 vjeçare dhe si kriter për përzgjedhje do të jetë çmimi më i ulët i ofruar. Shpjegoi se të gjitha të dhënat e tjera përmbahen në materialet pas pikës.

¹ (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 78/15, 106/15, 153/15, 190/16 dhe 21/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/19, 275/19 dhe 122/21),

Këshilli i Agjencisë njëzëri dhe miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: Shërbime hidraulike dhe elektrike.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për lëndën - shërbim: Shërbime hidraulike dhe elektrike është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele me nr.05-4729/1 datë 22.12 .2023, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Zëvendës Kryetari i Këshillit,
Selver AJDINI, d.v.**